



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 37 Prot

Tiranë më, 09/03/2020

VENDIM

“Për hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për autoritetet dhe organet drejtuese në ASA”

Bazuar në ligjin nr. 8485, dt. 12.05. 1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 131 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 08, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, urdhrin e Rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike Nr. 130 Prot, datë 02.03.2020 dhe të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 09.03.2020:

VENDOSI

1. Hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Rektor të ASA.
2. Hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për anëtar të Senatit Akademik të ASA.
3. Hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve, për përzgjedhjen e përfaqësuesit të studentëve si anëtar të Senatit Akademik të ASA-së.
4. Afati për dorëzimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e kandidatëve është nga data **09.03.2020-13.03.2020**.
5. Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet pranë sekretares së KIZ, znj. Albana Mema, nga ora 08-16.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Hasan Bello

ANËTARË:

Ervin Kaçi

Ergys Hasa

Erjena Lamaj

Anila Shorri

SEKRETARE

Albana Mema

